



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 322/2 Prot.

Durrës, më 14.02.2020

VENDIM

Nr. 13, datë 14.02.2020

PËR

"MIRATIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BURSIVE, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020, TË CILËT PËRMBUSHIN KRITERET PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT NË NEVOJË, QË NDJEKIN STUDIMET NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, PRANË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS".

Në zbatim të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", nenin 49 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 903, datë 21.12.2016, të ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 26.12.2018 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar me Vendimin nr. 39, datë 23.01.2019 të Këshillit të Ministrave, shkresave ardhura nga fakultetet, shkresën nr. 315, datë 13.02.2020 të Administratorit, Bordi i Administrimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, në mbledhjen e datës 14.02.2020,

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e bursave, për vitin akademik 2019 - 2020, për 66 studentë të cilët vijojnë studimet në vitin e parë dhe pas të parit në ciklin e parë të studimeve dhe vijnë nga shtresa sociale si kategori në nevojë sipas listave të hartuara nga komisionet e verifikimit të aplikimeve për përfitimin e bursës.
2. Efektet financiare në vlerën 5 9450 000 lekë për mbulimin e shpenzimeve për shpërndarjen e bursave për vitin akademik 2019 – 2020 të miratuara në pikën 1 të këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit (grantit) i miratuar , nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për vitin 2020, për Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - o Administratori
 - o Drejtoria e Administrimit Financiar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar i Bordit të Administrimit

